NEW SOCIAL INITIATIVE

PEACEBUILDING GROUP

KOLEKTIVI I KOSOVËS

PROMOVIMI I PAQES SHOQËRORE PËRMES DIALOGUT NDËRETNIK NË KOSOVË

Raporti i Kolektivit të Kosovës

Promovimi i paqes shoqërore përmes dialogut ndëretnik në Kosovë

Botues:
New Social Initaitive - NSI
Peacebuiding Group

Redaktor:
Jovana Radosavljević,
Milica Andrić Rakić,
Miloš Milovanović

Autor:
Ardit Orana,
Ramadan Ilazi

Përkthyes:
Bruno Nerizaj

Dizajni dhe radhitja:
Miloš Milovanović

Shtypi:
Pixel

Pristinë, Mitrovicë Veriore
Dhjetor 2021.

Përgjegjësia e vetme e këtij publikimi bie mbi autorin dhe botuesin. Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Fondit Ballkanik për Demokraci të Fondit Gjerman të Marshallit në SHBA (BTD), USAID-it ose Qeverisë së SH.B.A.-së.

Copyright © New Social Initiative

Përmbajtja

Hyrja 6

Diskutimet në Kolektivin e Kosovës: Dilema ndërmjet paqes dhe drejtësisë dhe potenciali për një Kosovë gjithëpërfshirëse 8

Konkluzionet 16

Hyrje

Në vitin 2021, Iniciativa e Re Sociale (NSI) dhe Grupi për Ndërtimin e Paqes, të mbështetur nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD), e kanë bashkuar një grup njerëzish nga Kosova dhe Serbia në atë që është quajtur "Kolektivi i Kosovës" për t'i diskutuar perspektivat dhe sfidat për arritjen e paqes më të qëndrueshme në Kosovë. Aktivistë të shoqërisë civile, politikëbërës, ekspertë, studiues dhe gazetarë ishin të përfshirë në këto biseda. Për t'i zbuluar dhe kuptuar më thellë bllokadat strukturore dhe rrethanore që e dobësojnë potencialin për paqe të qëndrueshme shoqërore në Kosovë, Kolektivi Kosovës ka trajtuar grupe të ndryshme tematike në diskutimin e tyre, si: si ndikojnë zhvillimet politike në konsensusin ndëretnik ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës për çështjet si dialogu për normalizim, përfaqësimi politik dhe autoriteti qendror; zgjedhjet dhe pjesëmarrja demokratike; potenciali për qytetari shumetnike dhe aktive; çështjet e diskutueshme që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe ngritjen e popullizmit dhe nacionalizmit.

Qëllimi i këtij raporti është ta ofrojë një përmbledhje të diskutimeve të Kolektivit të Kosovës të zhvilluara në pesë takimet e tyre gjatë vitit 2021. Diskutimet e Kolektivit të Kosovës u strukturuan si takime gjysmë formale, Chatham House, për ta lehtësuar një diskutim të hapur mbi temat që duket se i ndajnë serbët dhe shqiptarët në Kosovë. Ajo që i bën diskutimet e Kolektivit të Kosovës të jashtëzakonshme është se ato trajtuan çështje që konsiderohen të ndjeshme (p.sh. padia për gjenocid kundër Serbisë nga Kosova), por këto takime ishin të frymëzuara, të organizuara dhe të lehtësuara tërësisht në nivelin lokal, dhe në asnjë nga takimet nuk pati njeri nga jashtë (d.m.th. "dikë nga BE-ja") për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për diskutim. Kjo tregon aktivitetin e fuqishëm të shoqërisë civile në Kosovë dhe potencialin e saj për ta luajtur një rol më konstruktiv dhe më mundësues në procesin e përgjithshëm të normalizimit të marrëdhënieve.

Gjetjet kryesore:

1. Korniza e avancuar e Kosovës që i mbulon të drejtat e komuniteteve jo-shumicë është e njohur, por zbatimi efektiv i saj mbetet sfidë. Masat për ndërtimin e besimit ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës kanë rëndësi të madhe për procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe për marrëdhënie paqësore në Kosovë.

2. Serbët e Kosovës theksojnë se procesi i integrimit të veriut të Kosovës, dhe i komunitetit serb të Kosovës në përgjithësi, është ende i papëlqyeshëm në nivel të komunitetit dhe nuk do të ishte i mundur pa shtytjen e Beogradit zyrtar, megjithatë, ata mendojnë se, nëse ky proces do t'i shpjerë përpara garancitë politike, të drejtat dhe përfaqësimi duhet të avancohen. Nga ana tjetër, shqiptarët e Kosovës mendojnë se kompromisi me komunitetin serb u

përmbyll me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ose zakonisht i njohur si Plani i Ahtisarit.

3. Qeveria e Kosovës duhet të kontaktojë me përfaqësuesit e komunitetit serb dhe ta fillojë një bisedë për zhvillimin e politikave që do të ofronin zgjidhje të qëndrueshme dhe nuk do ta çrregullonin jetën e njerëzve në veri të Kosovës, në kuadër të procesit të integrimit.

4. Kosova veriore gjithashtu mbetet çështja kryesore për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Duhet të ketë transparencë më të madhe për marrëveshjet e mundshme, posaçërisht në një skenar në të cilin veriu i Kosovës është plotësisht i integruar dhe si do të funksiononte ajo në praktikë.

5. Për serbët e Kosovës, themelimi i Asociacionit / Bashkësisë së komunave me shumicë serbe (A/BKS) shihet si masë për ndërtimin e besimit dhe instrument kryesor për vazhdimin e bisedimeve për integrim, nëse ato do të ndodhin. Megjithatë, për shkak të karakterit të saj problematik dhe implikimeve të perceptuara për funksionalitetin e Kosovës, si dhe narratives së krijuar që nënkupton se A/BKS-ja është një Republika Srpska [Republikë Serbe] e re, A/BKS-ja e ka humbur apelin e saj ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe popullatës shumicë në Kosovë.

6. Dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë shihet si një proces shumë politik që e ka potencialin për transformimin e shoqërisë kosovare, por varet shumë nga vullneti i brendshëm politik dhe kredibiliteti i BE-së si një lehtësues i vendosur.

7. Përveç statusit të Kosovës, një tjetër çështje madhore në marrëdhëniet Kosovë - Serbi është e kaluara, apo mosballafaqimi me të kaluarën.

8. Përkundër mbështetjes së vazhdueshme të donatorëve ndërkombëtarë për ta lehtësuar integrimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, antagonizmat ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës nuk kanë parë ndonjë përmirësim të dukshëm. Përkundrazi, tendencat në retorikën etnopolitike kanë parë një rritje të mprehtë gjatë vitit të kaluar.

Raporti është i ndarë në dy pjesë të përgjithshme. Në pjesën e parë ofrohet një përmbledhje e diskutimeve të Kolektivit të Kosovës dhe theksohen argumentet kryesore, ndërsa në pjesën e fundit ofrohen shënime përmbyllëse mbi sfidat për rrugën përpara. Qëllimi i këtij raporti është ta ofrojë një kuptim më të mirë se si shihen çështjet relevante për paqen në Kosovë nga një grup i ndryshëm i aktorëve të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia dhe, në këtë mënyrë, ai synon ta informojë një diskurs më të mirë publik mbi disa nga çështjet e ngritura në këtë raport.

Diskutimet në Kolektivin e Kosovës: Dilema ndërmjet paqes dhe drejtësisë dhe potenciali për një Kosovë gjithëpërfshirëse

"Ajo që na mungon është përfaqësimi i barabartë, duhet të kemi komunikim të mirë përbrenda në mënyrë që të mund ta prezantojmë Kosovën si tërësi."[1]

Disa çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u trajtuan në pesë takimet e Kolektivit të Kosovës. Pikat kryesore të diskutimeve theksohen në këtë pjesë.

Korniza e avancuar e Kosovës që i mbulon të drejtat e komuniteteve jo-shumicë është e njohur, por zbatimi efektiv i saj mbetet sfidë. Masat për ndërtimin e besimit ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës kanë rëndësi të madhe për procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe për marrëdhënie paqësore në Kosovë. Raportet ndërkombëtare, si raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit mbi të Drejtat e Njeriut dhe raportet e brendshme të Kosovës nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, thonë se zbatimi i të drejtave të komuniteteve jo-shumicë nuk është i përhapur nëpër institucionet publike.[2] Për shembull, Ligji Nr. 06/L-114 për ZYRTARËT PUBLIKË thotë se "minimumi 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë."[3] Sipas raporteve të Qeverisë së Kosovës për gjendjen e shërbimit civil, përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil është rreth 9 për qind.[4] Ajo që e përkeqëson problemin është mungesa e një bisede kuptimplote për këtë temë pasi çështjet bëhen pjesë e debatit metapolitik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Për shembull, në një nga diskutimet e Kolektivit të Kosovës, tensionet e fundit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për targa u përdorën për të ilustruar se si mediat kosovare që raportonin për këtë temë në masë të madhe e injoruan zërin dhe perspektivën e qytetarëve të rëndomtë në veri të Kosovës dhe si situata dhe zgjidhjet e

[1] Shënime nga diskutimi në kolektivin e Kosovës, 15 maj 2021: Ferizaj.
[2] Shih Raportin e Departamentit të Shtetit mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut në Kosovë për vitin 2020, në dispozicion në: https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/; Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit 2020
[3] Shih Ligjin Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8 / 11 Mars 2019, Prishtinë, në dispozicion në: ActDetail.aspx (rks-gov.net) f. 5
[4] Shih Raportin mbi Gjendjen e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2018, në dispozicion në: https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/B38D28D3-7C94-48A0-AD17-2F55659FE14D.pdf p. 21

mundshme do të ndikonin në jetën e tyre të përditshme.[5] Nga ana tjetër, për të njëjtën çështje, një pjesëmarrës tjetër argumentoi se si serbët e Kosovës as nuk simpatizuan dhe as nuk dukej se e kishin kuptuar poshtërimin dhe problemet praktike nëpër të cilat po kalonin ata me targa të Kosovës kur udhëtonin për në Serbi[6], një pikë e kontestuar nga pjesëmarrësit serbë të Kosovës të cilët gjithashtu kanë përjetuar vështirësi të konsiderueshme me targat, përfshirë targat RKS.[7] Shkëmbimet në Kolektivin e Kosovës e kanë treguar mungesën e mirëkuptimit të ndërsjellë për problemet e praktikave të përbashkëta dhe dështimet tona për t'i parë ato probleme nga perspektiva e njëri-tjetrit.

Në këtë kontekst, përkushtimi i proklamuar i Qeverisë së Kosovës për një dialog të brendshëm me komunitetin serb në Kosovë është shumë i rëndësishëm dhe shoqëria civile duhet të konsultohet për hartimin dhe zbatimin e një ndërmarrjeje të tillë. Qeveria duhet t'i qaset procesit të dialogut të brendshëm me respekt dhe në mirëbesim. Ekzistojnë dy faktorë të rëndësishëm që duhet të merren parasysh në këtë drejtim. Së pari, përfshirja e shoqërisë civile në këtë proces është thelbësore, por edhe qasja. Organizatat e shoqërisë civile nuk duhet të instrumentalizohen thjesht për ta legjitimuar procesin, por, përkundrazi, ato duhet të përfshihen në mënyrë kuptimplote. Së dyti, në mënyrë që dialogu i brendshëm të ketë gjasa të mira për sukses, ai duhet të organizohet në konsultim të ngushtë me përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kosovë (d.m.th. Listën Serbe). Sipas diskutimeve në Kolektivin e Kosovës, përpjekjet për ta mënjanuar apo minuar Listën Serbe në një proces potencial të dialogut të brendshëm me komunitetin serb në Kosovë nuk do të rezultonin në një proces legjitim dhe të pranuar dhe do të mund ta përkeqësonin edhe më tej besimin e serbëve të Kosovës në institucionet publike. Një arsye tjetër që e bën një ndërmarrje të tillë të rëndësishme është parandalimi dhe luftimi i dezinformatave që synojnë krijimin e tensioneve etnike në Kosovë. Në këtë kontekst, Kolektivi i Kosovës e diskutoi rastin e znj. Dragica Gashiq, serbja e parë e kthyer në komunën e Gjakovës.[8] Diskutimi në Kolektivin e Kosovës theksoi se, edhe pse kthimi i znj. Gashiq u lehtësua nga Qeveria e Kosovës (përkatësisht nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në Gjakovë me mbështetjen e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës), reagimi publik shpuri në tregime kontradiktore.[9]

[5] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 8 tetor 2021: Brezovicë
[6] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 8 tetor 2021: Brezovicë
[7] Sipas Raportit mbi Sfidat dhe Arritjet në Zbatimin e Dialogut të Brukselit, të paraqitur në Kuvendin e Kosovës nga kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, në periudhën ndërmjet dhjetorit 2017 dhe shtatorit 2020 në dhjetë komuna me shumicë serbe, janë lëshuar mbi 27.000 patentë shoferë nga autoritetet e Kosovës, më së shumti në Mitrovicën e Veriut – 5.434.
[8] Shih: "Ne nuk i lejojmë serbët": i kthyeri i parë serb i qytetit kosovar i rihap plagët e kohës së luftës, nga Bekim Bislimi, Ludmilla Cvetkoviq dhe Andy Heil, Radio Evropa e Lirë, 8 korrik 2021, në dispozicion në: https://www.rferl.org/a/kosovo-serb-returnee-gjakova/31349094.html
[9] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 22 korrik 2021: Mitrovicë e Veriut

Sipas raportit vjetor të Departamentit Amerikan të Shtetit, në vitin 2020 Ministria për Komunitete dhe Kthim e ka ndihmuar kthimin e 273 personave në Kosovë, përfshirë 133 serbë të Kosovës.[10] Megjithatë, procesi i riintegrimit të të kthyerve të zhvendosur gjatë luftës në Kosovë ka qenë i politizuar në masë të madhe. Kjo ndikoi në gatishmërinë e Kosovës për t'i respektuar detyrimet e saj dhe për ta zbatuar kornizën e saj kombëtare ligjore lidhur me mbështetjen dhe koordinimin e riintegrimit të të kthyerve.[11] Serbët e Kosovës gjithashtu mendojnë se Qeveria është bërë më e vetëkënaqur lidhur me rastet e sulmeve me motive etnike.[12] Ngjashëm, rasti i shqiptarëve të Kosovës të zhvendosur në veri shpesh është anashkaluar nga komuniteti serb i Kosovës. Një raport i UNHCR-së i vitit 2017 mbi profilet e PZHBV-ve në Kosovë thekson se janë edhe 5.789 shqiptarë të Kosovës të zhvendosur në Kosovë, prej të cilëve 78% janë zhvendosur kryesisht nga Mitrovica e Veriut.[13] I njëjti raport thekson se janë mbi 16.000 serbë të zhvendosur në Kosovë dhe mbi 600 romë, ashkalinj dhe egjiptianë të zhvendosur brenda vendit.

Serbët e Kosovës mendojnë se avancimi i mbrojtjeve politike, i të drejtave dhe i përfaqësimit janë hapa thelbësorë në procesin e integrimit të veriut të Kosovës, ndërsa shqiptarët e Kosovës mendojnë se kompromisi me komunitetin serb u përmbyll me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ose zakonisht i njohur si Plani i Ahtisarit.[14] Bazuar në diskutimet në Kolektivin e Kosovës, duket se komuniteti shqiptar në Kosovë i percepton të drejtat dhe garancitë potenciale politike, të reja apo të avancuara, për komunitetin serb në Kosovë, jo si kërkesa të vërteta të komunitetit lokal, por më shumë si mjete për ta avancuar atë që ata e shohin si plan të Serbisë për ta krijuar një mekanizëm të stilit "Republika Serbe" në Kosovë. Për shembull, një nga pjesëmarrësit në diskutimet e Kolektivit të Kosovës, të mbajtura në Prizren, theksoi se "Nëse serbëve të Kosovës ua japim Asociacionin e komunave me shumicë serbe (A/BKS), ata do të duan më shumë."[15] Ndërsa, për serbët e Kosovës, siç u tha në po të njëjtin takim, marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për A/BKS-në nuk paraqet të drejta të reja politike për serbët e Kosovës, por të drejta tashmë të njohura në kornizën ligjore të Kosovës.[16] Në këtë kuptim, ka mungesë të besimit apo mosbesim mbi motivet për një plus apo shtesë të Planit të Ahtisarit, gjë që tregon se besimi ndërmjet komuniteteve në Kosovë mbetet i brishtë, por megjithatë është një përbërës thelbësor si për procesin e dialogut, ashtu edhe për qëndrueshmërinë e marrëveshjes që potencialisht do të arrihet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shkëmbimi ndërmjet shqiptarëve të Kosovës

[10] Shih raportin nga konferenca vjetore e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin 202a, në dispozicion në: https://kossev.info/jevtic-i-am-not-satisfied-with-the-returns-process-273-people-returned-to-kosovo-this-year/
[11] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 22 korrik 2021: Mitrovicë e Veriut
[12] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 22 korrik 2021: Mitrovicë e Veriut
[13] Shih kryeartikullin e UNHCR-së: Një fillim i ri për komunitetin e përzier në Kosovë, në dispozicion në: https://www.unhcr.org/see/wp-content/uploads/sites/57/2018/11/UNHCR_KOS_Profiling_English_Pages.pdf
[14] Shih Raportin e të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e Ardhshëm të Kosovës, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, 26 mars 2006, në dispozicion në: https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.pdf
[15] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 12 qershor 2021: Prizren
[16] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 12 qershor 2021: Prizren

dhe serbëve të Kosovës, në kornizën e diskutimeve të Kolektivit të Kosovës, tregon se përderisa shqiptarët e Kosovës mund të mos jenë plotësisht të vetëdijshëm apo të informuar mbi realitetin e zbatimit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, serbët e Kosovës nuk i kuptojnë shqetësimet e shumicës që marrëveshjet e reja të mundshme mbi të drejtat dhe përfaqësimin politik mund t'i kenë për funksionalitetin e shtetit. Çështja e asaj që raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit e quan "struktura të paligjshme paralele qeveritare në komunat me shumicë serbe në Kosovë"[17], u theksua në diskutimin e Kolektivit të Kosovës si shqetësim për shqiptarët e Kosovës. Nga ana tjetër, serbët e Kosovës frikësohen se shpërbërja e strukturave të kujdesit shëndetësor dhe arsimor, të sponsorizuara nga Qeveria serbe në komunat me shumicë serbe në Kosovë, pa një alternativë të qëndrueshme, mund ta përkeqësojë situatën edhe më shumë dhe ta lërë komunitetin pa shërbime thelbësore.[18] Citati në vijim, nga diskutimi i Kolektivit të Kosovës në Mitrovicën e Veriut, e ilustron këtë perceptim ndër komunitetin serb në Kosovë: "Nëse flasim për shpërbërjen e institucioneve paralele, ju lutem më thoni cili është plani për institucionet arsimore dhe shëndetësore? Sipas mendimit tim, ajo është një deklaratë populliste. Cila është alternativa ndaj sistemit arsimor që ende ekziston në Kosovë? Çfarë lloji të shkollimit ofrojnë institucionet e Kosovës? Çfarë lloji të sistemit shëndetësor? Cili është sistemi paralel? Për serbët e Kosovës, ai nuk është sistem paralel, por sistem primar"[19]. Megjithatë, për shqiptarët e Kosovës, varësia e komunitetit serb në Kosovë nga Beogradi shihet si zgjedhje politike.[20] Ndryshimet e mendimeve për këtë temë janë gjithashtu rezultat i mungesës së komunikimit kuptimplotë, ndërgjegjësimit dhe besimit ndërmjet komuniteteve. Prandaj, është thelbësore që Qeveria e Kosovës të kontaktojë me komunitetin serb dhe ta fillojë një bisedë rreth zhvillimit të politikave që do të ofronin zgjidhje të qëndrueshme dhe nuk do ta çrregullonin jetën e njerëzve në veri të Kosovës, brenda kornizës së procesit për integrim të negociuar me Beogradin.

Veriu i Kosovës mbetet çështja kryesore edhe për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Sipas pjesëmarrësve serbë të Kosovës, kërkohet transparencë më e madhe për marrëveshjet e mundshme, posaçërisht në një skenar në të cilin veriu i Kosovës është plotësisht i integruar dhe si do të funksiononte kjo në praktikë.[21] Qytetarët në veri të Kosovës janë vërtet të frikësuar dhe të brengosur për marrëveshjet politike karshi veriut sepse nuk janë të informuar siç duhet për zgjidhjet e mundshme, ndërsa zgjidhjet e mëparshme tashmë e kanë çrregulluar dukshëm jetën e tyre. Informimi i udhëheqjes politike të veriut të Kosovës (d.m.th. Listës Serbe) nuk është i barabartë me informimin e qytetarëve atje, por në praktikë duket se për të gjithë aktorët e përfshirë, biseda me udhëheqjen politike konsiderohet si e mjaftueshme.

[17] Shih Raportin e Departamentit të Shtetit mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut në Kosovë për vitin 2020, në dispozicion në: https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/
[18] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 22 korrik 2021: Mitrovicë e Veriut
[19] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 22 korrik 2021: Mitrovicë e Veriut
[20] Po aty.
[21] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 22 korrik 2021: Mitrovicë e Veriut

Diskutimet në Kolektivin e Kosovës kanë treguar gjithashtu se do të ishte kundërproduktive dhe potencialisht e dëmshme të minohej Lista Serbe si përfaqësim legjitim politik i komunitetit serb në Kosovë.[22] Megjithatë, Lista Serbe, veçanërisht në veri të Kosovës, në mënyrë aktive i minon standardet demokratike. Për shembull, në Raportin e Vendit për Kosovën 2020, të Bashkimit Evropian (BE), thuhet: "Zgjedhjet legjislative të tetorit 2019 ishin në përgjithësi të administruara mirë dhe transparente, por procesi i numërimit të votave i ekspozoi dobësitë. Fushata ishte konkurruese, përveç në zonat serbe të Kosovës, ku mjedisi i fushatës u dëmtua nga kërcënimet kundër kandidatëve dhe përkrahësve të Listës jo Serbe."[23] Përveç kësaj, udhëheqësit e tjerë politikë të Listës jo Serbe kanë deklaruar se liria politike në komunitetin serb në Kosovë është e kërcënuar nga veprimet e Listës Serbe, sepse "serbët e Kosovës janë të shantazhuar dhe vetë mbijetesa e tyre varet nga vota e tyre për Listën Serbe."[24] Përkundër kritikave ndaj Listës Serbe, është e qartë se derisa të arrihet një zgjidhje gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përfaqësimi politik i komunitetit serb në Kosovë formësohet dhe kushtëzohet nga Beogradi. Shoqëria civile në komunitetin serb në Kosovë, posaçërisht në veri, po përpiqet të kontribuojë në rritjen demokratike, përkundër kontekstit të vështirë në të cilin veprojnë dhe presionit nga të gjitha anët. Mirëpo, në të njëjtën kohë, ka pasur incidente të dukshme të frikësimit të votuesve serbë të Kosovës dhe të OJQ-ve.[25] Kjo gjithashtu u identifikua së voni nga përfaqësuesi i Mbretërisë së Bashkuar në konferencën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën më 15 tetor 2021, i cili e theksoi me shqetësim "frikësimin e organizatave joqeveritare serbe të Kosovës që punojnë me institucionet e Kosovës dhe të individëve që synojnë t'u bashkohen institucioneve shumetnike".[26] Këto incidente dhe pasojat e tyre rrallë diskutohen publikisht nga qytetarët serbë të Kosovës dhe OJQ-të për shkak të frikës së shtypjes së plotë nga ithtarët e Qeverisë së Serbisë në Kosovë.

Themelimi i Asociacionit / Bashkësisë së komunave me shumicë serbe (A/BKS) shihet nga qytetarët serbë të Kosovës si masë për ndërtimin e besimit dhe instrument kryesor për integrimin e institucioneve të mbetura serbe në Kosovë, nëse kjo arrihet në të ardhmen. Megjithatë, vonesat e mëtejme në themelimin e tij / saj mund ta zvogëlojnë potencialin e A/BKS-së si gur themel të një marrëveshjeje për paqe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.[27] Shumica shqiptare në Kosovë nuk e sheh gatishmërinë e komunitetit

[22] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 12 qershor 2021: Prizren

[23] Shih: Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020, 10 tetor 2020, në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/kosovo_report_2020.pdf p. 4

[24] Shih: Lista Serbe përballet me pak opozitë në zgjedhjet e ardhshme, nga Eraldin Fazliu dhe Jack Robinson, botuar në Prishtina Insight më 20 janar 2021, në dispozicion në: https://prishtinainsight.com/srpska-lista-facing-little-opposition-in-upcoming-elections/

[25] Shih Andy Heil (2019) "Bullying among Serbs sours Kosovo's Democratic Gains" [Bullizmi ndër serbët i prish fitimet demokratike të Kosovës], në dispozicion në: https://www.rferl.org/a/bullying-among-serbs-sours-kosovo-s-democratic-gains/30211468.html

[26] Shih Mbledhjen e 8880-të të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën, në dispozicion në: https://media.un.org/en/asset/k1a/k1amv96ton

[27] Shih Raportin e OJQ-së Aktiv (2015) mbi Bashkësinë / Asociacionin e komunave serbe, në dispozicion në: http://ngoaktiv.org/uploads/files/Community%20of%20Serbian%20Municipalities%20-%20The%20Sum%20of%20All%20Fears%20-%20Eng.pdf

serb në veri për t'u integruar në sistemin e Kosovës. Nga ana tjetër, serbët e Kosovës nuk kanë besim në institucionet publike të Kosovës për shkak të rezultatit të dobët të zbatimit të mekanizmave për të drejtat e komuniteteve. Çështjet e përmendura në këtë drejtim i referohen Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për Manastirin e Deçanit. A/BKS-ja ka qenë temë e diskutimeve të tensionuara në Kosovë dhe në Serbi. Në vitin 2013, kryeministri i Serbisë, Ivica Daçiq, dhe ai i Kosovës, Hashim Thaçi, nënshkruan një marrëveshje, me ndërmjetësimin e BE-së, e cila e përfshinte themelimin e Asociacionit / Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, e cila u detajua më tej në vitin 2015 me një marrëveshje të re ndërmjet të dy palëve.[28] Gjykata Kushtetuese e Kosovës i ka shqyrtuar të dyja marrëveshjet dhe më 23 dhjetor 2015 e ka nxjerrë aktgjykimin e saj, në të cilin thuhet se disa nga dispozitat e marrëveshjes së vitit 2015 për A/BKS-në nuk ishin plotësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës së Kosovës, por përfundon që A/BKS-ja duhet të themelohet në përputhje me marrëveshjen e vitit 2013 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilën Kuvendi i Kosovës e ka ratifikuar në qershor 2013.[29] Debati publik mbi A/BKS-në në Kosovë e shtrembëroi në masë të madhe të vërtetën për natyrën, karakterin dhe qëllimin e A/BKS-së[30]. Shqiptarët e Kosovës i frikësohen A/BKS-së për shkak të potencialit të tij / saj për ta bërë Kosovën jofunksionale, një perceptim që është i informuar nga zhvillimet me Republikën Serbe në Bosnje dhe Hercegovinë dhe i nxitur nga slogani zgjedhor i Listës Serbe - Sot votojmë Srpska, nesër ndërtojmë Srpska. Këto frika u përkeqësuan nga zhvillimet e fundit pasi udhëheqësi serb i Bosnjës, Millorad Dodik, diskutoi hapur për synimet e tij për shkëputje.[31] Megjithatë, siç u diskutua në Kolektivin e Kosovës, Kosova nuk është e organizuar si federatë dhe kushtet nuk janë të njëjta për një rezultat të ngjashëm si një Republikë Serbe në veri të Kosovës. Diskutimet në Kolektivin e Kosovës sugjerojnë se debati publik për A/BKS-në në Kosovë e ka minuar besimin e komunitetit serb në udhëheqjen politike të Kosovës, siç e ilustron citati nga diskutimi në Prizren "Dështimi për ta zbatuar A/BKS-në e krijoi një hendek të madh ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe serbëve të Kosovës dhe rezultoi në një besim dhe varësi të përtërirë në institucionet serbe në Kosovë ndër serbët vendas".[32] Megjithatë, A/BKS-ja po shihet gjithnjë e më shumë me skepticizëm ndër komunitetin serb në Kosovë, siç e ilustron citati nga diskutimi i Kolektivit të Kosovës në Prizren: "Beogradi po e përdor A/BKS-në për ta shpërfillur dialogun dhe po e përdor atë kundër Prishtinës. Nëse Lista Serbe dëshiron ta iniciojë atë, ata mund t'ua dërgojnë një kërkesë institucioneve të Kosovës.

[28] Shih: Serbia dhe Kosova nënshkruajnë marrëveshjen historike, nga Christoph Hasselbach, DW, 20 prill 2013, në dispozicion në: https://www.dw.com/en/serbia-and-kosovo-sign-historic-agreement/a-16758946

[29] Shih: Rasti nr. K0130/15, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, 23 dhjetor 2015 (Nr. AGJ877/15), në dispozicion në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf

[30] Shih Balkan Dialogues [Dialogët e Ballkanit]: Themelimi i Asociacionit / Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë, në dispozicion në: https://en.bfpe.org/wp-content/uploads/sites/5/2021/03/Andric-Rakic-and-Ilazi-Establishment-of-the-ASM.pdf

[31] Shih: West Struggles to Counter Secessionist Threat in Bosnia [Perëndimi lufton për ta kundërshtuar kërcënimin secesionist në Bosnje], nga Dino Jahiq, Zëri i Amerikës, 29 nëntor 2021, në dispozicion në: https://www.voanews.com/a/west-struggles-to-counter-secessionist-threat-in-bosnia/6332174.html

[32] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 12 qershor 2021: Prizren

Ata duan që Kosova të vazhdojë ta refuzojë A/BKS-në."[33] Me fjalë të tjera, sa më shumë që të zgjasë themelimi i A/BKS-së, aq më i madh është presioni dhe loja e fajësimit të Kosovës për mospërmbushjen e obligimeve të saj ndërkombëtare. Një temë e përbashkët në të pesë diskutimet e Kolektivit të Kosovës gjatë vitit 2021 rreth A/BKS-së ilustrohet më së miri me këtë citim nga diskutimi, në korrik, në Mitrovicën e Veriut: "Po ta kishte themeluar Kosova A/BKS-në në vitin 2015, sot do ta kishim një situatë krejt tjetër."[34]

Dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë shihet si proces shumë politik, që ka potencial për transformimin e shoqërisë kosovare, por varet nga vullneti i brendshëm politik për vendime të vështira, por edhe nga kredibiliteti i BE-së. Bashkimi Evropian (BE) e ka dëmtuar shumë reputacionin dhe kredibilitetin e vet në Ballkanin Perëndimor, posaçërisht në Kosovë, me dështimin për ta arritur liberalizimin e vizave për Kosovën. Qytetarët e Kosovës mbeten të vetmit të izoluar në Ballkanin Perëndimor dhe nuk mund të udhëtojnë lirshëm në BE. Kjo situatë vazhdon edhe përkundër rekomandimit të Komisionit Evropian dhe konfirmimit të tyre se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave, të cilin e ka konfirmuar edhe Parlamenti Evropian. Kosovarët nuk e ndajnë më entuziazmin për BE-në si më parë, dhe kjo ndikon në mënyrën si ata do ta shihnin dhe pranonin një marrëveshje të mundshme gjithëpërfshirëse në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, përfshirë themelimin e Asociacionit / Bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Qeveria e re e kryeministrit Albin Kurti u kritikua se nuk e vlerësoi rëndësinë e sigurimit të integrimit të plotë të komunitetit serb në Kosovë: "Mendoj që Kurti nuk e kupton rëndësinë e integrimit të serbëve të Kosovës. Ai nuk e kupton se çështjet e brendshme që mund të lidhen me dialogun e brendshëm duhet të diskutohen në Bruksel me Serbinë. Nëse ai dëshiron ta përfundojë procesin e integrimit, ai nuk e kupton se deri në çfarë niveli është i dezintegruar komuniteti serb."[35] Megjithatë, diskutimet e Kolektivit të Kosovës tregojnë që kryeministri Kurti shihet ta ketë mbështetjen e nevojshme popullore dhe fuqinë politike për ta transformuar procesin e dialogut dhe për ta sjellë procesin në përfundim: "Nëse është ndonjë person nga pala kosovare që mund ta përmbyllë dialogun, apo ta sjellë në një nivel të ri, ai është Kurti."[36]

Diskutimet e Kolektivit të Kosovës gjithashtu e theksojnë mungesën e qartësisë përsa i përket qasjes së Qeverisë ndaj dialogut. Me fjalë të tjera, ndërsa njihet potenciali i Kryeministrit në dialog, synimet dhe vizioni i tij për këtë proces janë më pak të qarta dhe kjo krijon pasiguri, posaçërisht ndër komunitetin serb në Kosovë. Kolektivi i Kosovës diskutoi edhe për çështje praktike që shihen me shqetësim nga komuniteti serb në Kosovë, siç është zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nga viti 2016,

[33] Po aty.
[34] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 22 korrik 2021: Mitrovicë e Veriut
[35] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 12 qershor 2021: Prizren
[36] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 12 qershor 2021: Prizren

që e mbështeti vendimin e vitit 2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila i konfirmoi të drejtat pronësore të Manastirit të Deçanit.[37] Në veçanti, dialogu i lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka pasur efekte shumë negative në shkëmbimet ndëretnike dhe perceptimet ndaj integrimit. Marrja e pronësisë së plotë, nga Serbia, e diskutimeve për integrimin e serbëve të Kosovës ka ndikuar shumë në mënyrën në të cilën aktorët politikë të Kosovës i formulojnë çështjet e dialogut në Kosovë. Përveç kësaj, qasja e paqartë institucionale e BE-së ndaj dialogut i ka dhënë prioritet angazhimit të vazhdueshëm konstruktiv të dykuptimshëm të palëve në dëm të gjenerimit të një rruge të përcaktuar qartë për integrimin e serbëve të Kosovës. Kjo asimetri ka bërë që serbët e Kosovës të mos e shohin integrimin në institucionet e Kosovës dhe në jetën publike dhe shoqërore si rrugë praktike. Për t'i menaxhuar me kujdes ankesat historike, shqiptarët e Kosovës duhet t'i trajtojnë koncesionet e dialogut si lojëra me shumën zero për të mos gjeneruar reagime publike. Kjo qasje, më pas, i largon më tej serbët e Kosovës dhe perspektivat e tyre për integrim. Mbështetja e përgjithshme e BE-së për këtë proces, përmes rolit të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian (EEAS) ka qenë e kufizuar. Lehtësimi i dykuptimshëm i EEAS-it është gjithashtu dëshmi e mungesës së autoritetit të tij vendimmarrës, i dëmtuar shpesh nga paaftësia e tij për ta zbatuar Politikën e Përbashkët për Punë të Jashtme dhe Siguri të BE-së (CFSP) dhe Politikën e Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje (CSDP). Asociacioni / Bashkësia e komunave serbe (A/BKS) dhe marrëveshjet për Energjinë i përshkruajnë pasojat e padëshiruara të lehtësimit të dykuptimshëm për perspektivat e integrimit të serbëve të Kosovës. Edhe pse është me rëndësi të theksohet se marrëveshja për A/BKS-në, e nënshkruar në vitin 2013, ishte sqaruar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese në vitin 2015, dhe, në atë drejtim, procesi nuk është viktimë e dykuptimësisë siç është e ujdive politike mbi fushën e autoritetit të A/BKS-së, si dhe e vullnetit politik për të ecur me zbatimin e tij nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Përveç statusit të Kosovës, një tjetër çështje madhore në marrëdhëniet Kosovë-Serbi është e kaluara, apo mosballafaqimi me të kaluarën. Për çështjen e të kaluarës u diskutua gjerësisht në kuadër të diskutimeve të Kolektivit të Kosovës. Tensioni për çështjet e drejtësisë dhe paqes dominonte në diskutim. Me fjalë të tjera, pyetja që u ngrit në diskutimin e Kolektivit të Kosovës në Brezovicë është: A mund të kenë paqe Kosova dhe Serbia pa drejtësi, apo a do të sakrifikohej paqja nëse do të insistohej në drejtësi. Ka çështje që i kapërcejnë interesat e mundshme politike në diskutimin për ballafaqimin me të kaluarën, siç është fati i të zhdukurve, për të cilat Kolektivi i Kosovës diskutoi dhe u pajtua se është një çështje që duhet të zgjidhet dhe duket që këtë bindje e ndajnë, së paku zyrtarisht, edhe Kosova edhe Serbia. Megjithatë, çështje të tjera si debati në Kosovë për një padi të mundshme kundër Serbisë për gjenocid, është temë që krijon përçarje dhe tensione.[38] Diskutimet në Kolektivin e Kosovës duket të

[37] Shih: Shtetet anëtare të Kuintit bëjnë thirrje për zbatimin e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për Manastirin e Deçanit, Euronews, 20 maj 2021, në dispozicion në: https://euronews.al/en/kosovo/2021/05/20/quint-member-states-call-for-implementation-of-kosovos-top-court-ruling-on-decani-monastery/

[38] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 15 maj 2021: Ferizaj

sugjerojnë që përderisa për shqiptarët e Kosovës padia për gjenocid kundër Serbisë ka të bëjë me ballafaqimin me të kaluarën dhe drejtësinë, për serbët e Kosovës kjo shihet si një strategji e krijuar për manovra politike në procesin e dialogut me Serbinë.[39]

Duket që diskutimet në Kolektivin e Kosovës për ballafaqimin me të kaluarën sugjerojnë që ky debat shihet nga komuniteti serb i Kosovës përmes thjerrëzës së nacionalizmit, siç ilustrohet nga ky citat: "Unë nuk po i mohoj gjërat që po ndodhin në Kosovë, por po kërkoj edhe drejtësi. Ajo që po përpiqem të them është se Serbia nuk arriti t'i bindë shqiptarët e Kosovës se ata ishin pjesë e shoqërisë dhe Kosova po dështon ta bëjë të njëjtën gjë tani me serbët e Kosovës. Nacionalizmi po sundon në Ballkan."[40] Në kontekstin e të kaluarës, një aspekt i rëndësishëm është edhe çështja e trashëgimisë kulturore, e cila paraqet një nga çështjet më të kontestuara që i pengon përpjekjet e vërteta për integrimin ndëretnik në Kosovë. Duke pasur parasysh shtrirjen e Planit të Ahtisarit, Aneksi V i Planit e rregullon statusin e trashëgimisë fetare dhe kulturore të komunitetit serb. Ndër të tjera, nga institucionet e Kosovës kërkohet që ta njohin Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë, si dhe paprekshmërinë e pronës së saj (Plani i Ahtisarit, Aneksi V). Një raport i Grupit Ndërkombëtar të Krizave në vitin 2010 mbi çështjen e eksterritorialitetit thoshte se "Rrjedhimisht, Beogradi dëshiron ta forcojë pozicionin e Kishës duke fituar së paku premtimin për eksterritorialitetin, garancat për marrëveshjen eventuale dhe mbrojtjen e kishave dhe manastireve nga një forcë ndërkombëtare pas largimit të forcave paqeruajtëse të NATO-s (KFOR). Duket sikur ka hapësirë që Qeveria në Prishtinë, e cila tashmë ka bërë lëshime të mëdha për Kishën gjatë bisedimeve të Ahtisarit, ta shqyrtojë edhe një herë këtë çështje, pa paragjykuar sovranitetin e saj."[41] Përderisa çështja e trashëgimisë kulturore nuk është trajtuar drejtpërsëdrejti në kontekstin e dialogut të lehtësuar nga BE-ja, mediat i kanë diskutuar planet e mundshme për statusin eksterritorial të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, të cilat shihen me shqetësim në Kosovë. Një analizë e Igor Novakoviqit, e publikuar nga BFPE-ja, thotë se "Për elitën në pushtet në Serbi, statusi i trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë është një nga çështjet më të rëndësishme. Sipas informatave jozyrtare, elita politike serbe në pushtet u përpoq të paktën që nga viti 2013 ta vendoste statusin e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në agjendën e negociatave të Brukselit, por ajo u refuzua."[42] Përveç kësaj, Novakoviq argumenton se kërkohet një zgjidhje e re dhe shqyrton opsione të ndryshme në analizën e tij.

[39] Po aty.

[40] Shënime nga diskutimi në Kolektivin e Kosovës, 15 maj 2021: Ferizaj

[41] Shih: KOSOVA DHE SERBIA PAS MENDIMIT TË GJND-së, Raporti i Evropës Nr. 206 – 26 gusht 2010, Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG), në dispozicion në: https://www.files.ethz.ch/isn/120587/206%20Kosovo%20and%20Serbia%20after%20the%20ICJ%20Opinion-1.pdf

[42] Shih: Balkan Dialogues [Dialogët e Ballkanit] mbi statusin e ardhshëm të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë dhe procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, në dispozicion në: https://en.bfpe.org/wp-content/uploads/sites/5/2021/03/Novakovic-On-the-Future-Status-on-Serbian-Religious-Heritage.pdf f. 3

Konkluzionet

Përkundër dekadave të iniciativave joqeveritare të sponsorizuara ndërkombëtarisht dhe të udhëhequra në nivel lokal për t'i mbështetur shkëmbimet ndëretnike dhe bashkëpunimin ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, antagonizmat ndërmjet këtyre dy komuniteteve vazhdojnë ta pengojnë çdo përparim të vërtetë. Antagonizmat ndërmjet elitave politike si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, vazhdojnë ta pengojnë çdo progres të mirëfilltë në drejtim të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve dhe qytetarëve të rëndomtë. Debatet publike rreth integrimit të sektorit specifik (d.m.th., arsimi, drejtësia, kujdesi shëndetësor etj.), shpesh takohen nga tregime konkurruese që, siç duket, janë kontradiktore. Serbët dhe shqiptarët e Kosovës, posaçërisht shoqëria civile, duhet t'i njohin argumentet asimetrike dhe të punojnë drejt ndërtimit të një qasjeje të bazuar në dëshmi për shqyrtimin strukturor të implikimeve të integrimit të sektorit specifik në strukturën e përgjithshme shoqërore në Kosovë. Për sa kohë që qytetarët e riprodhojnë retorikën politike të elitës në debatet ndëretnike në bazë, perspektivat për diskutime të bazuara në prova zbehen shumë. Në mungesë të kësaj, diskutimet për integrimin e serbëve të Kosovës brenda institucioneve të Kosovës vështirë se do ta prodhojnë ndonjë konsensus ndëretnik.

Perspektivat për një paqe të qëndrueshme në Kosovë kurrë nuk kanë qenë më të largëta. Duke i pasur parasysh trajektoret aktuale në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi dhe paralajmërimet në lidhje me zbatimin e kornizës ligjore për të drejtat e komuniteteve, integrimi i serbëve të Kosovës mbetet temë e diskutueshme. Ky raport i ka sintetizuar disa nga elementet më të rëndësishme që kanë ndikuar në vazhdimësinë e një paqeje negative në Kosovë dhe në sfidat e mëvonshme strukturore që e kanë legjitimuar këtë. Ndërsa institucionet publike të Kosovës janë përgjegjëse për adresimin e një numri të këtyre sfidave (që lidhen drejtpërdrejt me nivelin e zbatimit të të drejtave të komuniteteve), edhe natyra e centralizuar e përfaqësimit politik të serbëve të Kosovës i vështirëson perspektivat për një paqe pozitive.

Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Fondit Ballkanik për Demokraci të Fondit Gjerman të Marshallit në SHBA (BTD), USAID-it ose Qeverisë së SH.B.A.-së.

Projekti mbështetet nga Fondi Ballkanik për Demokraci i Fondit Gjerman të Marshallit në SHBA dhe USAID.

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND